



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

PROJEKTI I BURIMEVE UJORE DHE UJITJES

Projekti Nr. P121186; Huaja Nr. 8211-AL

Shpall

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

Për Shërbimet e Konsulencës Individuale

**“Konsulent për Mbrojtjen Mjedisore & Sociale dhe Monitorimin dhe Vlerësimin e Projektit”
(Nr. Referencës së Prokurimit MARD/CS/IC/007)**

Kjo kërkesë për shprehje interesi është vazhdim i Njoftimit të Përgjithshëm të Prokurimit për këtë projekt, publikuar në faqen e Zhvillimit të Biznesit në 25 Maj 2010; në Njoftimin e Përgjithshëm, përditësuar në 20 Dhjetor 2012, me referencë në Zhvillimin e Biznesit Nr. WB5260-12/12.

Qeveria e Shqipërisë ka marrë një hua nga Banka Botërore në shumën ekuivalente 31 milion Euro, për financimin e Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes dhe parashikon të aplikojë pjesë të këtij fondi për pagesën e Shërbimit të Konsulencës Individuale për **“Konsulent për Mbrojtjen Mjedisore & Sociale dhe Monitorimin dhe Vlerësimin e Projektit”** (me kohë të plotë).

✓ **Objektivat e Detyrës**

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT) është ngritur në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) me përgjegjësitë kryesore për menaxhimin, prokurimin dhe menaxhimin financiar, monitorimin dhe vlerësimin e Projektit, përfshirë monitorimin dhe raportimin e përputhshmërisë për mbrojtjen (mjedisore & sociale). Objektivi i këtij Shërbimi Konsulencë është monitorimi i pajtueshmërisë së aktiviteteve të Projektit me instrumentat Mjedisore & Socialë. Përveç kësaj, Konsulenti do të jetë përgjegjës për Monitorimin & Vlerësimin e Projektit.

✓ **Fusha e punës**

Detyrat dhe Përgjegjësitë: Detyrat specifike të përcaktuara në Termat e Referencës, që do të ndërmerren nga Konsulenti për Mbrojtjen Mjedisore & Sociale dhe Monitorimin dhe Vlerësimin e Projektit përfshijnë, por, jo domosdoshmërisht kufizohen në detyrat e listuara më poshtë:

Për sa i përket Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale:

Konsulenti do të asistojë Koordinatorin e Projektit dhe Menaxherin e Projektit dhe do të punojë ngushtë me stafin e Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit dhe Sektorit të Projekteve të Bujqësisë dhe Blegtorisë për të trajtuar kërkesën në rritje në lidhje me përgjegjësitë lidhur me Mbrojtjen Mjedisore dhe Sociale.

- Ndërmarrja e vizitave në terren dhe në bazë të shqyrtimit, kontrollit dhe dokumentimit të pajtueshmërisë me masat për zonat specifike siç janë paraqitur në PMMS të zonave specifike;
- Të udhëzojë kontaktorët, supervizorët në terren dhe palët e tjera të interesit për mënyrat e zbatimit dhe dokumentimin e përputhshmërisë në lidhje me masat lehtësuese dhe monitorimin e mjedisit, siç paraqiten në PMMS të zonave specifike;
- Të sigurojë që të gjitha dokumentet e nevojshme për të siguruar pajtueshmëri të plotë me instrumentet për Mbrojtjen Mjedisore & Sociale, në veçanti, Planet e Menaxhimit Mjedisore dhe Social (PMMS) dhe Planet e Veprimtimit për Rivendosje (PVR) janë përgatitur, përditësuar rregullisht dhe janë në dispozicion të aktorëve përkatës;

- Të sigurojë që aktivitetet e projektit, zhvilluar si pjesë e Projektit, janë projektuar të përfshijnë shmangien e risqeve të mundshme sociale dhe mjedisore, siç rekomandohet në PMMS dhe PVR të përgatitur tashmë për Rehabilitimin e Skemave/Sistemeve të Ujitjes;
- Të sigurojë mbikqyrjen e përgjithshme të Menaxhimit Mjedisor dhe Social gjatë zbatimit të aktiviteteve të WRIP dhe të këshillojë Klientin në adresimin e çështjeve mjedisore;
- Të sigurojë që secili nënprojekt dhe aktivitetet në kuadër të projektit i është nënshtruar procedurave të Planeve të Menaxhimit Mjedisor Social të Projektit;
- Të shqyrtojë nënprojektin dhe planin e aktiviteteve, projektet, kostot dhe dokumentet e tenderit dhe të përfshihet në prokurimin e Punimeve Civile dhe Supervizionit për të siguruar që kontratat e Punimeve Civile dhe Supervizionit të përfshijnë dispozita në lidhje me çështjet e mbrojtjes mjedisore dhe sociale;
- Të koordinojë me agjencitë përkatëse për marrjen e lejeve mjedisore, sipas nevojës;
- Të komunikojë me Pushtetet Lokale, Kontraktorët dhe me Ekspertin Mjedisor, Social, Shëndetësor dhe të Sigurisë, që është pjesë e Ekipit të Supervizionit, në të gjitha çështjet që lidhen me projektin, zbatimin, dokumentimin dhe raportimin mbi pajtueshmërinë mjedisore, siç tregohet në PMMS të zonave specifike;
- Të monitorojë zbatimin nga Kontraktorët të PMMS të zonave specifike për të siguruar që proceset dhe procedurat e duhura të menaxhimit të jenë në vend, që masat e lidhura me mbrojtjen mjedisore dhe sociale të adresohen në mënyrë adekuate dhe të sigurojë që në rast të një mospërputhjeje, veprimet korrigjuese të dakortësuara janë aplikuar dhe dokumentuar ;
- Të kontrollojë dhe sigurojë që raportet e radhës janë përgatitur dhe dorëzuar në kohë nga Kontraktori sipas përmbajtjes së rënë dakord dhe të japë komente, sipas rastit;
- Të përgatisë raportet gjashtëmujore të pajtueshmërisë së PMMS, sipas përshkrimit, siç kërkohet nga Banka Botërore;
- Të marre pjesë në misionet e rregullta dhe të tjera dhe vizitat teknike nga Banka Botërore dhe të punojë ngushtë me Specialistët e Mjedisit dhe Sociale të Bankës Botërore për të siguruar përputhjen e Projektit me politikën përkatëse mjedisore dhe sociale;
- Të ndërmarre veprime të tjera që lidhen me aspektet mjedisore dhe sociale të Projektit, siç mund të udhëzohet nga Menaxheri i Projektit dhe Koordinatori i Projektit herë pas here, me qëllim që të sigurohet pajtueshmëria e plotë e Projektit me standardet dhe legjislacionin mjedisor dhe social kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për sa i përket monitorimit dhe vlerësimit të projektit:

Konsulenti do të jetë përgjegjës për Monitorimin dhe Vlerësimin e Projektit (M & E), hartimin e qasjeve strategjike dhe teknike për zbatimin e qëllimeve të projektit brenda kornizës teknike të përshkruar për Monitorimin e Rezultateve. Konsulenti do të koordinojë dhe punojë me anëtarët e tjerë të PMT, në veçanti me stafin që MBZHR ka caktuar nga Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit dhe Sektori i Projekteve të Bujqësisë dhe Blegtorisë Departamenti IT për të operuar MIS që është në vend për prezantim e treguesve të monitorimit të Projektit. Përveç kësaj, jo/ai do të punojë gjithashtu ngushtë me Konsulentin që do të kontraktohet për të kryer Anketimin Monitorimin & Vlerësimin në fund të Projektit dhe të facilitojë mbledhjen e informacionit.

- Të shqyrtojë dhe familjarizohet me dokumentet e Projektit, në veçanti me Manualin e Operimit të Projektit (POM) dhe Sistemin e Monitorimit të Informacionit (MIS) tashmë të krijuar;
- Të kryejë përgatitjen dhe zbatimin e të programit të M dhe V dhe mbajtja e shënimeve mbi arritjet, ndarjet e treguesve;
- Të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme progresin drejt Objektivit të Zhvillimit të Projektit (PDO) dhe në përputhje me Treguesit e Monitorimit të Performancës të dakortësuar;
- Të raportojë në raportet gjysmëvjetore mbi PDO dhe kornizën e rezultateve të përditësuar;
- Të monitorojë zbatimin e projektit dhe të vlerësojë rezultatet për secilin komponent dhe nënkomponent, duke përdorur MIS;
- Të përcaktojë nëse inputet në projekt janë shfrytëzuar mirë;
- Të monitorojë zbatimin e projektit kundrejt planit të aktiviteteve (fizike dhe financiare), analizoje arsyet për vonesat, nëse ka, dhe masat dhe zgjidhjet e propozuara për kapercimin e tyre;
- Të sigurojë që aktivitetet e Projektit të zbatohen siç duhet sipas programit të dakortësuar dhe të ndërmarre veprime korrigjuese kur është e nevojshme;

- Të identifikojë praktikat e mira brenda projektit dhe avantazhet dhe të regjistrojë mësimet e nxjerra për t'u konsideruar në të ardhmen;
- Të kryejë rolin dhe përgjegjësitë e dhëna nga Koordinator i Projektit ose Menaxheri i Projektit;
- Të mbështesë anketimin e përfituesve dhe vlerësimet e tjera në fund të projektit, duke përfshirë edhe shkrimin e Raportit të Ministrisë në Përfundim të Zbatimit të Projektit.
- Të marrë të gjitha masat e nevojshme për mirëmbajtjen e MIS për ta mbajtur atë funksional;

✓ **Kërkesat për Kualifikim dhe Eksperienca**

Kandidati i përshtatshëm për pozicionin e Konsulentit për Mbrojtjen Mjedisore & Sociale dhe Monitorimin & Vlerësimin e Projektit duhet të ketë kualifikimet në vijim:

- Diplomë Master, preferohet në Shkenca Mjedisore, Inxhinieri Mjedisi ose kualifikime profesionale ekuivalente të përshtatshme për këtë Shërbim Konsulencë;
- Një minimum 5 (pesë) vjet experiencë përkatëse në monitorimin e Mbrojtjes Mjedisore & Sociale;
- Njohuri të rregulloreve dhe ligjeve Shqiptare (veçanërisht në proceset e VNM) është e kërkuar;
- Familjaritet me politikën e mbrojtjes (Mjedisore & Sociale) të Bankës Botërore do të jetë një avantazh;
- Njohuri dhe përvojë në Monitorimin & Vlerësimin e Projektit është e dëshirueshme;
- Aftësi në përdorimin e kompjuterit dhe paketave “office software” (përpunim në word, spreadsheet etj.). Përvoja në trajtimin e të dhënave të bazuara në web dhe Sistemet për Menaxhimin e Informacionit do të jetë një avantazh i shtuar;
- Shkrim dhe folur rrjedhshëm e gjuhës Shqip dhe Anglisht;

✓ **Afutet**

Pritet që Konsulenti të ofrojë shërbimet duke filluar (planifikuar) në Qershor 2018 dhe do të punojë me kohë të plotë. Detyrat për këtë Shërbim Konsulencë përfshijnë shqyrtimin në zyrë dhe punën në terren. Konsulenti për Mbrojtjen Mjedisore & Sociale dhe Monitorimin & Vlerësimin e Projektit do të punojë nën drejtimin dhe do të raportojë tek Menaxheri dhe Koordinator i Projektit (të Burimeve Ujore dhe Ujitjes).

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) fton individë të kualifikuar të tregojnë interesin e tyre në ofrimin e shërbimeve. Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin: (i) një letër motivimi, duke nënvizuar avantazhet e tyre lidhur me këtë pozicion, (ii) Curriculum Vitae si dhe (iii) informacion, që tregon që ata kanë kualifikimet e kërkuara për kryerjen e Shërbimeve të Konsulencës, (iv) referenca të ndryshme. Materialet duhet të dorëzohen në gjuhën Angleze.

Kriteret e shortlistimit janë:

- | | |
|---|---------|
| 1. <i>Kualifikimet e Pergjithshme</i> | 30 pikë |
| - <i>Diplome Master sic kerkohet</i> | |
| - <i>Kualifikime dhe certifikata pas-universitare</i> | |
| 2. <i>Përshtatshmëria për detyrën</i> | 60 pikë |
| - <i>Eksperience Specifike ne Monitorim Mjedisor & Social dhe Monitorim & Vleresim Projektesh</i> | |
| 3. <i>Familjaritet me politikën e mbrojtjes (Mjedisore & Sociale) të Bankës Botërore dhe experiencë në MIS</i> | 10 pikë |

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar tërhiqet në paragrafin 1.9 të *Udhëzuesit të Bankës Botërore: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nën kreditë dhe Grantet e IBRD dhe IDA, botimi Janar 2011*, ku përcaktohet politika e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.

Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është përzgjedhja e **Konsulentit Individual (IC)**, në përputhje me procedurat për përzgjedhjen e Konsulentëve Individualë të përcaktuara në *Udhëzuesin: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore, botimi Janar 2011*.

Konsulentët e interesuar mund të marrin informacion të mëtejshëm në lidhje me Termat e Referencës në faqen zyrtare të MBZHR: www.bujqesia.gov.al ose në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00 - 16:30 (E hënë – E enjte) dhe 08:00 - 14:00 të Premten:

Z. Ilirjan LAME

Menaxher Projekti

Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, kp. 1001 Tiranë, Shqipëri

Tel: + 355 4 2226243 - 75129

e-mail: ilirjan.lame@bujqesia.gov.al

Shprehjet e Interesit duhet të dorëzohen jo më vonë se data **04 Qershor 2018**: të printuara (personalisht ose me postë) në adresën e mëposhtme, brenda orarit zyrtar, dhe elektronikisht në adresën e e-mailit më sipër.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (Zyra e Protokollit)

Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, kp. 1001 Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Znj. Aurora ALIMADHI

Sekretar i Përgjithshëm